



Employer  
Branding  
Academy



duapune.com

# Akademia

## e Imazhit të Punëdhënësit





# Kujt i drejtohet ky trajnim?

- Specialistëve të Imazhit të Punëdhënësit
- Menaxherëve të Imazhit të Punëdhënësit
- Drejtorëve të BNJ
- Menaxherëve të BNJ
- Gjeneralistëve të BNj
- Menaxherëve të Talenteve
- Menaxherëve të Komunikimit
- Profesionistëve të Marketingut
- Rekrutuesve

## Qëllimi i këtij trajnimi.

Përfundimi me sukses i këtij trajnimi do të thotë të mësoni se si të planifikoni strategji, ndërtoni dhe matni ndikimin e imazhit (brendit) të punëdhënësit të organizatës suaj. Kursi ju mëson një strukturë të provuar që jo vetëm që do t'ju lejojë të krijoni një propozim fitues të vlerës së punëdhënësit (Employer Value Proposition), por do të harmonizojë talentin dhe qëllimet e biznesit, duke u dhënë pjesëmarrësve një ndikim më strategjik dhe influencues brenda organizatës së tyre.

# Arsyet pse duhet ta ndiqni këtë trajnim.

- Njohuri unike.
- Takim me Ekspertë.
- Fleksibilitet në studim (9 javë e-learning, 2-3 orë studim/javë)
- Rrjetëzim me profesionistë Alumni të cilët ndajnë me ju njohuritë dhe praktikat më të mira.
- Certifikim – në përfundim të trajnimit pajiseni me një certifikatë unike globale.

## Modulet

### Fleksibilitet në mësimin online.

Programi në internet është plotësisht fleksibël dhe përshtatet lehtësisht rreth orarit tuaj. Ju vendosni kur dhe ku doni të studioni. Nëse dëshironi, mund të filloni trajnimin tuaj sot.

- Moduli 1. **PSE DUHET NDJEKUR AKADEMIJA E IMAZHIT TË PUNËDHËNËSIT?** Ky modul do t'ju japë një kuptim të vlerës së Imazhit të Punëdhënësit dhe hapave kryesorë që duhet të ndërmerreni për të krijuar një themel të fortë për strategjinë e Imazhit tuaj të Punëdhënësit.
- Moduli 2. **NDËRTIMI I STRATEGJISË.** Ky modul do t'ju ndihmojë të identifikoni dhe zhvilloni një strategji që do të ndërtojë një imazh më të fortë të punëdhënësit dhe do të ofrojë në mënyrë më efektive nevojat kryesore të talentit të organizatës suaj.



**Moduli 1 dhe 2.** Kohëzgjatja e rekomanduar e studimit: 4 javë.

*Përafërsisht 2-3 orë vetë-studim çdo javë.*

- Moduli 3. **TREGONI HISTORINË TUAJ.** Ky modul do t'ju ndihmojë të komunikoni mesazhin e duhur për njerëzit e duhur përmes mediave të duhura.
- Moduli 4. **MATJA E REZULTATEVE.** Ky modul do t'ju japë një kuptim të vlerës së Imazhit të Punëdhënësit dhe hapave kryesorë që duhet të ndërmerreni për të krijuar një themel të fortë për strategjinë e Imazhit tuaj të Punëdhënësit.

**Modulet 3 dhe 4.** Kohëzgjatja e rekomanduar e studimit: 4 javë.

*Përafërsisht 2-3 orë vetë-studim çdo javë.*

## **Certifikimi - PRAKTIKO NJOHURITË E REJA.**

Filloni të përdorni njohuritë dhe mjetet që keni marrë gjatë trajnimit. Moduli i fundit është një rast studimi real, ku ju aplikoni njohuritë, mjetet dhe strukturën tuaj në një ushtrim përfundimtar.



## Çfarë përfshin trajnimi online.

- E gjithë literatura trajnuese në platformën eLearning.
- Diplomë certifikimi dhe distinktiv dixhital (digital badge).
- Anëtarësimi në Rrjetin Alumni të akademisë, për ndarjen e vazhdueshme të praktikave më të mira.
- Mbështetje nga ekipi i përkushtuar gjatë gjithë trajnimit.
- Dy uebinarë të regjistruar paraprakisht.
- Në dispozicion në anglisht, mandarin dhe frëngjisht.
- 

## Certifikimi

Pas përfundimit të trajnimit online, ju do të merrni një diplomë certifikimi të njohur globalisht dhe një bexhë digjitale të certifikimit (digital certification badge). Ju gjithashtu do të fitoni anëtarësim në një rrjet ekskluziv Alumni për ndarjen e praktikave më të mira të vazhdueshme.

# Akademia e Imazhit të Punëdhënësit

Cilat janë përfitimet e këtij trajnimi?

## PËRFITIMET FINANCIARE

- 28% qarkullimi më i ulët i punonjësve
- 50% kosto më të ulët për punësimin
- Njerëzit e duhur, me aftësitë e duhura dhe arsyet e duhura – ata do të rrijnë më gjatë dhe të jenë më shumë të lidhur – e cila nga ana tjetër do të japi rezultate më të mira.

## PËRFITIMET E REKRUTIMIT

- Në një studim të kohëve të fundit, 36% e punëkërkesve thanë që imazhi i punëdhënësit është gjëja më e rëndësishme në një punë potenciale.
- Nivele më të larta të angazhimit të punonjësve, i cili nga ana tjetër shoqërohet me 10% kënaqësi më të lartë të klientit, 21% nivele më të larta të produktivitetit dhe 22% më të lartë përfitimi.

## PËRFITIME TË TJERA

- Rritja e ambasadorëve dhe referimeve
- Rritja e renditjes si punëdhënës interesantë midis konkurrentëve.

KOHA PËR TË BINDUR DREJTUESIN TUAJ!

Shprehni interesin tuaj për pjesëmarrje [këtu](#)